


Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri, 2018


Blerina Metanj (Subashi)

24 Maj 2019

Matja e shtrirjes dhe natyrës së dhunës në nivel kombëtar



Në përputhje me Agjendën 2030, për matjen e Treguesve të Zhvillimit të Qëndrueshëm nëpërmjet kësaj anketë realizohet matja e treguesve:



- Anketa është planifikuar në PSZ 2007-2021.


Anketa e I	Anketa II	Anketa III
Viti 2007	Vitit 2013	Viti 2018
12 Qarqe	12 Qarqe	12 Qarqe
Gratë 15-49 vjeç	Gratë 18-55 vjeç	Gratë 18-74 vjeç
Dhuna nga një partner intim	Dhuna nga një partner intim	Dhuna nga një partner intim
Dhuna ndaj fëmijëve	Dhuna nga një jo patner (fizike)	Dhuna nga një jo partner Fizike+ Seksuale
		Dhuna në një lidhje Ngacmimi seksual Përndjekja



Anketa u zhvillua për 5 javë, 12 Nëntor-17 Dhjetor
Stafi në terren
-13 Mbikqyrës
-51 Anketues
-Vetëm gra
-3 Pyetësorë në ditë


-3.600 NJEF kampioni fillestar
-4.613 NJEF u kontaktuan, pasi disa banesa fillestare ishin bosh, shkatërruar ose tjetërsuar
-3.528 NJEF kishin gra që plotësonin kushtet
-3.443 gra kampioni përfundimar që u analizua
-97,5 % e grave pranuan të intervistohen

- Një grua për NJEF
- Vetëm gratë 18-74 vjec pavarësisht statusit civil
- Sigurimi i privatësisë
- Përdorimi i tabletave




Sjelljet kontrolluese


Ndonjëherë



Aktualisht



- 20,6% e grave deklarojnë se bashkëshorti i tyre bëhet xheloz kur ata flasin me burra të tjerë.
- 13% e grave deklarojnë se bashkëshorti i tyre kërkon të dijë për vendodhjen e tyre gjatë gjithë kohës.
- 6% deklarojnë se bashkëshorti i tyre tenton të kontrollojë rrjetet e tyre sociale.



- Ju ndalon të gjeni një punë, të shkoni në punë, të tregtoni, të fitoni para apo të merrni pjesë në projekte që gjenerojnë të ardhura

4,0 %


- Ju merr të ardhurat apo ju kontrollon paratë apo pronat kundër vullnetit tuaj

3,8 %


- Refuzon t'ju japë paratë që ju nevojiten për shpenzimet e familjes, edhe kur ka para për gjëra të tjera (si alkool apo cigare)

2,9 %

Ndonjëherë




Aktualisht




- 14,2 % e grave deklarojnë se janë fyer ose bashkëshorti i ka bërë të ndihen keq.
- 10,3 % deklarojnë se janë ndjerë të pavlera.
- 4,5 % deklarojnë se bashkëshorti i ka poshtëruar në sy të njerëzve të tjerë.

Ndonjëherë



Aktualisht




- 6,4 % e grave deklarojnë se bashkëshorti i ka qëlluar me shpullë 12 muajt e fundit.
- 2,6 % raportojnë se i ka shkukur flokët.
- 1,5 % raportojnë se i ka goditur me një objekt, i ka shtyrë në tokë apo tërhequr zvarrë.


- 72,4 % e grave raportojnë lëndime nga ushtrimi i dhunës fizike 12 muajt e fundit.
- 61,1 % e tyre raportojnë frikë, ankth, depresion, ndjenja izolimi, pagjumësi dhe/ose nervozizëm.
- 28,1 % raportojnë të prera, të gërvishtura, dhimbje, skuqje apo ënjtje dhe/ose shenja të lehta.
- 5,6 % e tyre kanë patur nevojë për kujdes shëndetësor dhe pse nuk e kanë marrë atë.
- 7,7 % i janë drejtuar kujdesit shëndetësor nga dëmtimet
 - 13,7 % e tyre i kanë treguar stafit mjekësor
 - 0.5% e tyre raportojnë se kanë humbur punën si pasojë e dëmtimeve



Ndonjëherë



Aktualisht



- Ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale kur nuk keni dashur

2,1%


- Ju ka detyruar të kryeni akte seksuale që nuk i keni dashur apo që ju janë dukur degraduese

0,1%

- Keni kryer marrëdhënie seksuale me bashkëshortin/partnerin sepse keni pasur frikë nga ajo që mund të bënte nëse e refuzonit


3,3%

**Partneri nuk pranon përdorimin e metodave
kontraceptive**




- Mënyra e kontrollit kryesisht është nëpërmjet dhunës psikologjike, 79,7 %
 - 51,9% janë kërcënuar se do të lihen ose përzehen nga shtëpia nëse përdorin metoda kontraceptive

Ndonjëherë



Aktualisht




Variabla shpjegues dhe kontekstual


- 50% e grave që kanë raportuar dhunë nga partneri raportojnë se dhuna ka filluar brenda vitit të tretë të martesës.
- Gratë të cilat përjetonin aktualisht dhunë në familje (66,8 %) kishin dy herë më gjasa ta shihnin bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur shumicën e ditëve, krahasuar me gratë të cilat nuk përjetonin dhunë në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (33,2%).

- 47,7 % e grave që kishin përjetuar dhunë në familje kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjen e tyre.
- Fëmijët e nënave që kanë përjetuar dhunë kishin dy herë më shumë gjasa krahasuar me fëmijët nënat e të cilave nuk ishin të ekspozuara në dhunën në familje të përjetonin ankthe, urinim ose të ishin të ndojtur.
- Gratë në grupimet më të larta të të ardhurave, kanë më shumë gjasa të përjetonin sjellje kontrolluese shtrënguese, dhunë psikologjike dhe/ose dhunë ekonomike, se sa dhunë fizike dhe/ose seksuale.

Ndonjeherë




Aktualisht




- 65,8 % e vajzave raportuan sjellje kontrolluese nga partneri me të cilin kanë marrëdhënie
- 88,9 % e autorëve janë të moshës 25-34 vjeç pasi dhe kampioni i vajzave 18-24 vjeç dhe përfshin vetëm gra/vajza të cilat nuk kanë bashkëjetuar ose të martuara me partner.

Ndonjëherë




Aktualisht




- Matja e dhunës fizike dhe seksuale nga një jopartner që nga mosha 15 vjeç.
- Kryesisht autorët e dhunës fizike kanë qenë nëna (76,1 %) /babai (58 %), mësuesi (35,7 %).
- Përqindjet më të lartë të autorëve të dhunës seksuale raportohen shok klase (15,1%), mësuesi (7,1 %).
- 6,6 % kanë treguar për këtë lloj dhune.
- 4,6 % kanë kërkuar ndihmë


Gratë që kanë raportuar dhunë nga një jo partner që në moshën 15 vjeç




Dhunë seksuale nga një jo partner që në moshën 15 vjeç



Ndonjëherë




Aktualisht




- 12,2 % komente rreth trupit dhe/ose pamjes së tyre fizike, që i ka bërë ato të ndihen jo rehat, apo të ofenduar.
- 5,9 % pyetje personale rreth jetës së tyre seksuale, intime apo private.
- Vendi i ndodhjes është në rrugë (82,9 %), të ndjekura nga shkollat (42,3 %), pazaret/dyqanet (38,3 %), në shtëpinë e gruas (29,1 %), në vendin e punës (25,8 %), në makina, autobusë dhe në mjete të tjera transporti (19,9 %), 1,2 % në shtëpinë e dhunuesit.
- Gratë raportuan se kishin qenë të panjohur (79,3 %) dhe miq/të njohur (51,2 %) shokë pune (13,8 %) dhe të dashurit aktualë/të dikurshëm (10,1%).

Ndonjëherë



Aktualisht




- 4,5 % e grave deklarojnë se gjatë 12 muajve të fundit kanë patur telefonata të përsëritura ofenduese, kërcënuese ose të heshtura.
- 2,5 % kanë patur mesazhe të përsëritura, të padëshiruara në rrjete sociale.
- Nga këto gra vetëm 39,4 % e kanë konsideruar këtë sjellje si përndjekje.
- Moshat 18-24 vjec përjeton në mënyrë të konsiderueshme më shumë përndjekje se moshat e tjera (21,9 % dhe 19,7 %).
- 97 % raportojnë se nuk e njohin autorin, të dashur aktualë ose i mëparshëm 13,8 %, kolegët 3,5 %.

- 1 në 2 gra mendonin se komuniteti beson se dhuna midis burrit dhe gruas është një çështje private dhe se të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë.
- 46,5 % mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se një grua duhet të durojë një farë dhune për të ruajtur familjen.
- 27,5 % e grave mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se kur një grua rrihet nga burri i saj, faji apo gabimi është pjesërisht i saj.
- 1 në 4, mendojnë se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se gruaja duhet të ketë turp, apo të ndihet keq të flasë me dikë nëse është përdhunuar.
- 21,2 % e grave mendonin se të gjithë, apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se nëse një grua përdhunohet, ka të ngjarë që të ketë bërë diçka të pakujdesshme që e ka vënë veten në një situatë të tillë.
- 75,4 % mendojnë se dhuna në familje është një problem i madh në vend.
- 70 % mendojnë se dhuna seksuale është një problem i madh në vend.


	2018 (18-74 vjec)		2013 (18-55 vjec)	
	Ndonjëherë	Aktuale	Ndonjëherë	Aktuale
Dhuna në familje	47.0	33.7	59.4	53.7
Dhuna nga një jo partner	18.2	2.3	6.9	-

Krahasimi i llojeve të dhunës




Krahasimi i rezultateve duke mbajtur të njëjtën grupmoshë, 18-55 vjeç

■ 2013 ■ 2018



Krahasime me anketën e vendeve anëtare 2014, %



- 1 në 2 gra në vend ka përjetuar në jetë një lloj dhune (në familje, në një lidhje, nga një jo partner, ngacmim seksual ose përndjekje) dhe 1 në 3 e përjeton të paktën një lloj dhunë gjatë 12 muajve të fundit.
- Ka një lidhje të fortë midis përjetimit të dhunës nga një partner intim me përjetimin e dhunës nga një partner jo intim në fëmijëri.
- Sjelljet kontrolluese, dhuna psikologjike janë llojet e dhunës që fillojnë të parat, ato shfaqen që në vitin e parë të martesës ose para saj. Dhuna ekonomike dhe seksuale tentojnë të shfaqen me vonë gjatë vitin të dytë ose të tretë të martesës.
- Gratë në Shqipëri vuajnë në heshtje, vetëm 16,9 % e grave që kanë përjetuar një lloj dhunë në familje dhe kanë treguar. Ndërkohë 30,8 % e grave që kanë përjetuar dhunë seksuale kanë treguar. Kjo tregon se në shumë raste sjelljet kontrolluese, dhuna psikologjike dhe ekonomike janë raste të cilat gratë nuk i tregojnë askujt për to.
- Raportimet në rrjete formale janë më të ultat, vetëm 4,4 % e grave deklarojnë se kanë shkuar në polici dhe 3,1 % tek një mjek.
- Dhuna ndaj grave është e parandalueshme duke rritur rolin e statistikave në drejtim të fuqizimit të politikave për dhunës ndaj grave duke marrë parasysh dhe faktorët e riskut si dhuna në fëmijëri përdorimi i alkoolit, fuqizimi i sigurisë në ambiente publike etj.

Ju faleminderit për vëmendjen !